



CeSID

CENTAR ZA SLOBODNE IZBORE I DEMOKRATIJU
CENTER FOR FREE ELECTIONS AND DEMOCRACY



**Të kuptosh shkaqet,
të krijosh të ardhmen:**
**Drejt pajtimit në
jug të Serbisë**

02 / 14 / 2025

Sadržaj

1 / Hyrje — 3

2 / Metodologjia dhe përshkrimi i mostrës — 4

3 / Përmbledhje — 5

4 / Kualiteti i jetës, perceptimi i të ardhmes dhe sigurisë në
Preshevë dhe Bujanoc — 8

5 / Paraqitja dhe shkaqet e incidenteve ndëretnike — 11

6 / Besimi në institucione — 18

7 / Perceptimi i konflikteve të armatosura, ballafaqimi me të
kaluarën dhe roli i institucioneve të drejtësisë — 21



Centar za slobodne izbore i demokratiju (CeSID)

Dositejeva 8

Telefon: 011/407 56 05

e-mail: cesid@cesid.rs

Zvanična prezentacija: www.cesid.rs

FB/TW: CeSIDBeograd

Mart 2025. godine

Qendra për zgjedhje të lira dhe demokraci realizon projektin „Të kuptosh shkaqet, të krijosh të ardhmen. Drejt pajtimit në jug të Serbisë“, me qëllim të avancimit të procesit të pajtimit nëpërmjet programeve të bashkëpunimit dhe aktiviteteve profesionale. Njëra prej aktiviteteve kryesore në kuadër të këtij projekti është përpilimi i një raportit hulumtues i cili merret me perceptimin e të rinjëve mbi demokracinë, vlerat demokratike dhe drejtësinë tranzicionale. Raporti i cili ndodhet në vazhdimin e këtij dokumenti, bazohet në analizën e detajuar të të dhënave të grumbulluara nëpërmjet metodës reprezentative të 300 të rinjëve të të gjitha etnive në komunat Preshevë dhe Bujanoc.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të ofrojë qasje në qëndrimet e të rinjëve karshi temave që kanë të bëjnë me pajtimin ndërnacional, kualitetin e jetës, sigurinë, dhe besimin në institucionet e Republikës së Serbisë. Vëmendje të veçant ky raport i kushton sfidave me të cilat ballafaqohet procesi i pajtimit ndërmjet bashkësisë shqiptare dhe serbe në jug të Serbisë, duke marr parasysh rrethanat historike të cilat kanë prodhuar konflikte të armatosura, si dhe specifikat e përbërjes multi-etnike të këtyre komunave. Raporti poashtu tregon edhe rëndësinë e implementimit efikas të drejtësisë tranzicionale në procesin e pajtimit, si dhe shpërfaqë pengesat si mungesën e besimit, barrierat kulturore dhe gjuhësore dhe mungesën e mekanizmave efikase për zgjidhjen e çështjeve të hapura.

Projekti Të kuptosh shkaqet, të krijosh të ardhmen: Drejt pajtimit në jug të Serbisë' po zbatohet me mbështetje nga Kabineti i Ministrisë pa portofol të ngarkuar për pajtim, bashkëpunim rajonal dhe stabilitet shoqëror.

2 / Metodologjia dhe përshkrimi i mostrës

Hulumtimi u realizua nga	Qendra për zgjedhje të lira dhe demokraci (CeSID)
Periudha e hulumtimit	Nga 22. janari deri më 4. shkurt 2025.
Lloji dhe sasia e mostrës	300 të rinjë të moshës 15 deri në 30 vjeç në Preshevë dhe Bujanoc
Teknika e hulumtimit	Sy më sy (F2F)
Instrumenti hulumtues	Pyetësori që përbëhej prej 38 variablave

Struktura gjinore e të anketuarve: 39% femra, 61% meshkuj.

Mosha e të anketuarve: 15 deri 19 vjet 32%; 20 deri 25 vjet 34%, 26 dhe më shumë vjet 34%

Struktura e edukimit të anketuarve: pa shkollim/shkolla fillore 4%, zanatlinjë 9%, shkolla e mesme 46%, shkolla e lartë/fakulteti 19%, nxënës/student 22%.

Statusi i punësimit: të punësuar në administratën publike 9%, të punësuar në kompani private 33%, sipërmarrës 2%, të papunë/kërkojnë punë 21%, të papunë/nuk kërkojnë punë (nxënës, pensionist) 35%.

Vendbanimi: fshat 49%, qytet 51%

Nacionaliteti: shqiptar 62%, serb 30%, rom 7%

Komuna: Preshevë 33%, Bujanoc 67%.

3 / Përmbledhje

Në mesin e të rinjëve në rajonin e Preshevës dhe Bujanocit mbizotron paknaqësia në jetën e tyre e cila prodhon edhe dëshirën, brenda kësaj popullsie, që të largohen nga vendi ku jetojnë dhe të ikin nga shteti i Serbisë. Dëshira që dominon tek të rinjtë të cilët kanë marr pjesë në hulumtim është dëshira që jetën e tyre ta vazhdojnë në njërin nga shtetet e Bashkimit evropian.

Dëshira për të jetuar në njërin nga shtetet e Bashkimit evropian është posaçërisht e theksuar në mesin e shqiptarëve të rinjë, por nuk duhet të përjashtohet edhe si dëshirë e dy bashkësive tjera etnike në jug të Serbisë – serbe dhe rome.

Ndjenjën e pakënaqësisë me jetërat e tyre tek të anketuarit, deri diku, e kompenzon besimi dhe shpresa se në të ardhmen mund të bëhet mirë, si dhe optimizmi i treguar qartë i cili në përgjithësi karakterizon popullsinë e re, jo vetëm në këtë pjesë të vendit, por në të gjithë Serbinë.

Gjetjet e këtij hulumtimi tregojnë se raportet ndërnjerzore në këto dy komuna janë kryesisht të mira, ndërsa incidente ndërnacionale pothuajse nuk ka fare, prandaj edhe ndjenja e sigurisë është në masë të konsiderueshme prezente tek të anketuarit tonë. Megjithatë, nuk duhet assesi ta anashkalojmë faktin që përgjat hulumtimit, 40% të të anketuarve kanë shprehur paknaqësitë e tyre me gjendjen e të drejtave të njeriut në nivel lokal. Ky mund të jetë edhe njëri prej motiveve që çon drejtë paknaqësisë së qytetarëve me kualitetin e jetës së tyre, që qytetarët ndihen të diskriminuar dhe që të rinjtë dëshirojnë të ardhmen e tyre ta ndërtojnë në ndonjë vend tjetër. Duhet patjetër të theksohet se incidentet ndëretnike më së shumti i vërejnë romët e rinjë, që mund të jetë e rëndësishë së veçant me rastin e komunikimit me këtë bashkësi etnike.

Në të ardhmen, vëmendje e veçant për krijimin e mardhënieve në jug të Serbisë duhet t'i kushtohet faktit që shumica e të anketuarve e pranon se ka njoftësi në mesin e bashkësive tjera, por që nuk shoqërohen intenzivisht, që tregon tregon në fakt se bashkësitë e ndryshme etnike në këtë rajon shpesh jetojnë njëri pranë tjetrit, dhe jo bashkë. Kategoria e të anketuarve e cila është në mënyrë të veçant e rrezikuar në këtë situatë, në brendësi të të cilave përfaqësuesit e tyre më së paku shoqërohen, janë të anketuarit e moshave më të reja – ata që kanë nga 15 deri në 19 vjet dhe të cilët, natyrshëm, do duhej të kishin më së shumti kontakte të ndërsjella me moshatarët e tyre në vendet ku jetojnë.

Distanca etnike të cilën të rinjtë e tregojnë, në masë më të madhe është e theksuar ndaj komunitetit rom. Më shumë se gjysma e të anketuarve që kanë marr pjesë në hulumtim nuk dëshirojnë që për fqinjë të tyre të kenë romët. Kjo është një e dhënë alarmante. Në anën tjetër, shkalla më e lartë e distancës etnike në mes të serbëve dhe shqiptarëve mund të vërehet kur bëhet fjalë për bashkëjetesa martesore, ndaj të cilave të anketuarit kanë hezitime të theksuara.

Avancimin e mardhënieve ndëretnike në rrethin ku jetojnë, të rinjtë e shohin nëpërmjet përmirësimit të situatës ekonomike në rajon, si dhe nëpërmjet zgjidhjeve në sferën e arsimit – shkolla të përbashkëta dhe mësim të gjuhëve që fliten në mesin e bashkëmoshtarve të bashkësive tjera etnike.

Mardhëniet ndëretnike mund të avancohen edhe nëpërmjet rritjes së besimit në institucione të cilat formësojnë jetën e përditshme të të rinjve në këtë rajon. Të anketuarit më së paku besim kanë në institucionin e presidentit të Republikës së Serbisë dhe ndaj Qeverisë së Republikës së Serbisë. Besimin më të madhë e kanë ndaj institucioneve fetare dhe pushteteve lokale.

Rritja e besimit në punën e ktyre institucioneve është e mundshme nëpërmjet angazhimit më të madhë të tyre në pajtimin ndëretnik në shtetin ku jetojnë. Në këtë moment, dy të tretat e të anketuarve kanë deklaruar se institucionet e shtetit të Serbisë aspak nuk punojnë dhe më shumë nuk punojnë se sa që punojnë në pajtimin ndëretnik. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme sepse 61% e të rinjve nga Presheva dhe Bujanoci konsiderojnë që është shumë e rëndësishme zgjidhja e krimeve nga e kaluara për hirë të ndërtimit të një të ardhme më të mirë, ndërsa më shumë se gjysma e të rinjve nga Presheva dhe Bujanoci nuk besojnë në efikasitetin e institucioneve të drejtësisë në Serbi dhe në procesimin e krimeve të luftës.

Ekziston shumë pak vetëkritikë në mesin e të rinjëve në Bujanoc dhe Preshevë, pa mar parasysh se cilit nacionalitet i përkasin. Dy të tretat e të anketuarve (66%) kanë deklaruar se nacionaliteti të cilit i përkasin nuk ka bërë asgjë të keqe. Cdo i dhjeti (10%) ka deklaruar se çfarëdo që ka bërë populli të cilit i takojnë e ka bërë për vetmbrojtje. Rreth 9% kanë deklaruar se edhe nëse është bërë keq është bërë përshkak të rrethanave të asaj kohe dhe të bëmat e popullit të tyre janë më pak të kqija se sa të bëmat e popujve tjerë. Prandaj është me rëndësi të punohet që popullësia e këtij rajoni, por edhe popullësia e gjithë Serbisë të njohet me faktet të cilët do t'i siguronin një fotografi më të qartë të ndodhive që në vete bartin pasoja afatgjate.



4 / Kualiteti i jetës, perceptimi i të ardhmes dhe sigurisë në Preshevë dhe Bujanoc

Pjesa më e madhe e të anketuarve (30%) thekson se më shumë është i pakënaqur se sa që është i kënaqur me jetën e tyre. Cdo i katërti anketues thekson se është më shumë i kënaqur se sa i pakënaqur, ndërsa 27% e të anketuarve theksojnë se janë të kënaqur me jetën e tyre. Mbi mesataren janë të kënaqur të anketuarit të cilët kanë kryer shkolla profesionale (zanatlinjtë), nxënësit/studentët, sipërmarrësit, të punësuarit në administratën publike dhe qytetarët. Është interesant edhe deklarimi i bazuar në baza nacionale. Tek romët dhe serbët është më shumë prezente kënaqësia – përgjigjen më shumë të kënaqur se sa të pakënaqur e kanë zgjedhur 67% romët dhe 75% serbët. Në anën tjetër, shumica e shqiptarëve kanë deklaruar se janë më shumë të pakënaqur se sa të kënaqur ose janë shumë të pakënaqur – 51%. Mesatarisht të anketuarit nga Presheva janë më shumë të kënaqur se të anketuarit nga Bujanoci (39% me 19% e të anketuarve). Ndërsa çdo i dhjeti i anketuar ka deklaruar se është shumë i pakënaqur.


Grafikoni 4.1 Në çfarë mase jeni të kënaqur, me %



Të anketuarit e kanë pasë mundësinë të zgjedhin se cili është disponimi i cili më së shpeshti paraqitet tek ata. Pjesa më e madhe e të anketuarve ka theksuar se më së shpeshti i paraqitet besimi që së shpejti do të bëhet mirë – 29%. Ngjashëm, 28% e të anketuarve ka përzgjedhur ndjenjën e shpresës dhe optimizmit.


Cdo i dhjeti i anketuar ka deklaruar se është i gatshëm të marr pjesë në ndryshime. Ndjenja diçka më negative – pafuqi dhe pashpresë kanë deklaruar 11% e të anketuarve, indiferencë kanë treguar 9% e të anketuarve, brengë dhe frikë 7% dhe zemërim dhe mllef kanë treguar 1% e të anketuarve. Ndjenja negative si pafuqi, brengë dhe të tjera janë mbi mesataren prezente tek përfaqësuesit e komuniteti serb dhe rom (indiferencën e përmend çdo i pesti anketues). Besimi se do të bëhet më mirë zë vend më shumë tek të rinjtë shqiptar – 34% e të anketuarve. Ngjajshëm, besimi se do të bëhet mirë vërehet më shumë në Komunën e Preshevës (41%) në raport me komunën e Bujanocit (23%).

Grafikoni 4.2 Cili nga disponimet shfaqet më së shpeshti tek ju, në %




Numri më i madhë i të anketuarve jetën e vet në të ardhmen e sheh në njërin prej shteteve të Bashkimit evropian – 46%. Kjo është përgjigja të cilën e ka dhënë edhe shumica e të anketuarve shqiptar – 56%. Ngjajshëm, një përgjigje si kjo më së shpeshti e kanë dhënë të anketuarit nga komuna e Preshevës – 60% e tyre. Jashtë shtetit jetën e tyre në të ardhmen e shohin edhe 20% të të anketuarve, edhe atë 12% në njërin nga shtetet e rajonit ndërsa 8% në shtetet që ndodhen jashtë Evropës. Në Bujanoc, rrespektivisht në Preshevë, do të qëndronin 16% e të anketuarve. Këtë përgjigje, mbi mesataren, e kanë zgjedhur përfaqësuesit e komunitetit rom – 24% e të anketuarve. Jetën e vet në ndonjë qytet tjetër të Serbisë e sheh çdo i dhjeti i anketuar, ndërsa në mesin e serbëve, kjo përgjigje nxen vend tri herë më shumë - 28% e të anketuarve.

Grafikoni 4.3 Ku e shihni jetën tuaj në të ardhmen, në %



Shumica e të anketuarve konsiderohet si relativisht e sigurtë – 51% e tyre, prej të cilëve 34% e të anketuarve deklarohet se më shumë ndjehen të sigurt se sa të pasigurt, ndërsa 17% deklarohet se ndjehen shumë të sigurt. Mbi mesataren, të sigurt ndjehen nxënësit/studentët, banorët që jetojnë në qytete, sipërmarrësit, të punësuarit në administratën publike, si dhe romët dhe serbët. Në total 78% e serbëve theksojnë se ndjehen më shumë të sigurt se sa të pasigurt ose mjaftueshëm të sigurt. Poashtu, të anketuarit nga komuna e Preshevës ndjehen më të sigurt se të anketuarit e komunës së Bujanocit – 31% e të anketuarve kanë deklaruar se ndjehen shumë të sigurt, kundrejt 10% të cilët ndjehen të sigurt nga të anketuarit në Bujanoc. Në anën tjetër, 31% e të anketuarve janë deklaruar se ndjehen më shumë të pasigurt se sa që ndjehen të sigurt ndërsa 6% e të anketuarve ndjehen shumë të pasigurt.


Grafikoni 4.4 A ndjeheni të sigurt në vendin ku jetoni dhe nëse po, në çfarë mase, në %



5 / Paraqitja dhe shkaqet e incidenteve ndëretnike

Shumica e të anketuarve (53%) ka ndjenjën e paknaqësisë në raport me gjendjen në të drejtat e njeriut në Bujanoc dhe Preshevë, prej të cilëve 40% deklaroi se janë më shumë të pakënaqur se sa të kënaqur, ndërsa 13% që janë shumë të pakënaqur. Mbi mesataren janë të pakënaqur shqiptarët – 65% në total. Gati se një e katërta e të anketuarve (24%) deklaroi se janë më shumë të kënaqur se sa të pakënaqur me gjendjen e të drejtave të njeriut, ndërsa 8% e të anketuarve deklaroi se janë shumë të kënaqur – në total 32%. Duke i kryqëzuar me të dhënat demografike, vërehet se të kënaqur me të drejtat e njeriut, mbi mesataren, janë të anketuarit të cilët kanë përfunduar shkollat profesionale apo zanatet (57%), banorët e qytetit (41%), përfaqësuesit e komuniteti rom (47%) dhe përfaqësuesit e komuniteti serb (67%). Në anën tjetër, 13% e të anketuarve kanë deklaruar se janë shumë të pakënaqur me gjendjen e të drejtave të njeriut në komunat ku jetojnë.


Grafikoni 5.1 Në çfarë mase jeni të kënaqur me gjendjen e të drejtave të njeriut në Bujanoc dhe Preshevë, në %



Numri më i madhë i të anketuarve ka deklaruar se në rrethin ku jetojnë nuk ka aspak incidente ndëretnike – 46% e të anketuarve. Pjesa tjetër e të anketuarve deklaroi se incidentet ndëretnike ekzistojnë, por në masa të ndryshme. Kështu, 16% e të anketuarve ka deklaruar se ka incidente ndëretnike, por në masë shumë të vogël, 30% e të anketuarve se ka incidente ndëretnike, por shumë

rrallë dhe 7% e të anketuarve se ka incidente ndëretnike shpesh, ndërsa vetëm 1% ka deklaruar se ka incidente ndëretnike në baza të përditshme. Në mesin e të anketuarve që kanë deklaruar se ka pasur incidente, mbi mesataren janë të përfaqësuar romët – çdo i treti ka deklaruar se ka incidente ndëretnike shpesh. Përderisa në komunën e Preshevës 74% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk ka incidente ndëretnike, në Bujanoc një deklaram të till e kanë bërë 32% e të anketuarve. Në mesin e personave të cilat kanë deklaruar se ka incidente ndëretnike, arsyet pse ato ndodhin janë të ndryshme. Kështu 27% e të anketuarve kanë deklaruar diskriminimin në baza etnike, ndërsa 24% provokimet e shpeshta kundrejt përfaqësuesve të etnive të caktuara. Diskriminimin në baza nacionale mbi mesatare e theksojnë romët – 32% e të anketuarve. Provokime të rregullta karshi përfaqësuesve të nacionaliteteve të tjera më së shumti e kanë deklaruar anketuesit e komunitetit serb (33%) dhe rom (32%), ndërsa 7% e të anketuarve shqiptar kanë zgjedhur këtë përgjigje. Në një perceptim si ky, udhëheqin përfaqësuesit e komunitetit rom. Cdo i pesti i anketuar si arsye përmend konfliktet dhe luftat pasojat e të cilave zgjasin edhe sot. Qërimet hesapsh kriminale në të cilat marrin pjesë përfaqësuesit e komuniteteve të ndryshme si arsyeje për konflikte ndëretnike e shohin 15% e të anketuarve, 7% e të anketuarve përmendin pozitën e keqe të një komuniteti, 1% përmendin intereset personale të palëve të përfshira në konflikt.


Grafikoni 5.2 Sipas njohurive tuaja, a ka incidente ndëretnike në rrethin në të cilin jetoni. Nëse ka, sa shpesh, në%



Më shumë se një e treta e të anketuarve (36%) kanë përmendur se mardhëniet ndëretnike në rrethin ku ata jetojnë, në komuna, por edhe në të gjithë rajonin janë më shumë të mira se sa të këqija. Të kundërtën, rrespektivisht se mardhëniet janë më shumë të këqija se sa të mira kanë deklaruar 24% e të anketuarve. Mardhëniet ndëretnike si shumë të mira i cilësojnë 17% e të anketuarve, ndërsa 4% e tyre i vlersojnë si shumë të këqija. Nëse i krahasojmë me të dhënat demografike, vërehet se notë më pozitive në raport me mardhëniet ndëretnike kanë dhënë


gjinia femrore (46% e të anketuarve femra kanë vlersuar se mardhëniet ndëretnike janë më shumë të mira se sa të këqija, ndërsa 24% prej tyre i konsiderojnë si shumë të mira), njejt sikur nxënësit dhe personat me shkollim të lartë – me nga 50% e të anketuarve nga këto dy kategori konsiderojnë se mardhëniet ndëretnike janë më shumë të mira se sa të këqija. Serbët dhe romët kanë një perceptim më pozitiv mbi mardhëniet ndëretnike – në total 68% e të anketuarve serb dhe 57% e të anketuarve rom i shohin mardhëniet ndëretnike si të mira ose shumë të mira, ndërsa në anën tjetër një perceptim të ngajshëm e kanë 44% e të anketuarve shqiptar. Ngjajshëm, 77% e të anketuarve nga komuna e Preshevës mardhëniet ndëretnike në përgjithësi i shohin pozitive, ndërsa në Bujanoc si të tilla mardhëniet ndëretnike i shohin 39% e të anketuarve.

Grafikoni 5.3 Si do t'i kishit vlersuar në përgjithësi mardhëniet ndëretnike në rrethin ku ju jetoni?, në %




Të anketuarit janë pyetur poashtu se cila është arsyeja kryesore për shkak të së cilës mardhëniet ndëretnike në rrethin ku ata jetojnë nuk janë më të mira se kaq. Përgjigja që më së shpeshti e kanë zgjedhur është që arsyeja kryesore është diskriminimi në baza nacionale dhe të njejtën e kanë përmendur 21% e të anketuarve. Shqiptarët në masë më të madhe e kanë zgjedhur këtë përgjigje në raport me serbët dhe romët. Arsye tjetër sipas 17% të të anketuarve janë konfliktet nga e kaluara të cilët janë aktuale edhe sot, mosnjohjen e gjuhës së njëri tjetrit dhe mungesën e besimit ndërmjet pjestarëve të etnive të ndryshme e kanë përmendur 13% e të anketuarve, konfliktet politike të cilët shndërrohen në konflikte nacionale 12% e të anketuarve, ndërsa rritjen në bashkësi etnike të izoluar, duke mos pasur kontakte të ndërsjella e kanë përmendur 11% e të anketuarve. Mungesën e besimit si përgjigje më së shpeshti e kanë zgjedhur të anketuarit nga Presheva 29%, derisa në Bujanoc 23% e të anketuarve e kanë zgjedhur përgjigjen që ka të bëjë me konfliktet nga e kaluara të cilët janë aktuale edhe sot. Vetëm 1% e të anketuarve përmend se arsyeja kryesore pse mardhëniet ndëretnike nuk janë më të mira ka të bëjë me konfliktet politike ndërmjet shteteve të ndryshme.

Grafikoni 5.4 Cila është arsyeja kryesore për shkak të së cilës mardhëniet ndëretnike në rrethin ku ju jetoni nuk janë më të mira?, në %



Të anketuarit janë pyetur që të karakterizojnë shkallën dhe kualitetin e mardhënieve me personat që i përkasin bashkësive tjera etnike. Numri më i madhë i të anketuarve (44%) kanë përmendur se njohin njerëz nga bashkësitë tjera etnike, por nuk shoqërohen shumë. Mandej 26% e të anketuarve theksojnë se kanë miq të mirë që vijnë nga bashkësitë tjera etnike. Partner të punës në mesin e përfaqësuesve të etnive të tjera kanë 14% e të anketuarve, dhe këtë përgjigje mbi mesataren e kanë zgjedhur përfaqësuesit e bashkësisë etnike serbe – çdo i treti. Persona nga bashkësitë e tjera etnike në rrethin e vet familjarë kanë 10% e të anketuarve, prej të cilëve 6% kanë deklaruar se janë në lidhje me persona të përkatësive tjera etnike, e 4% e të anketuarve deklarojnë se kanë farefis të përkatësive tjera etnike. Në anën tjetër, 15% e të anketuarve kanë deklaruar që nuk shoqërohen me persona që i përkasin bashkësive tjera etnike. Duke krahasuar të dhënat demografike, vërehet se me pjestarë të bashkësive tjera etnike nuk shoqërohen të anketuarit që i përkasin kategorisë nga 15 – 19 vjet – 27% të tyre.

Grafikoni 5.5. A keni ju personalisht komunikim me personat që i përkasin bashkësive tjera etnike, dhe nëse po, në çfarë raporte jeni (mund të zgjedhni më shumë se një përgjigje) në %



Një grup i veçant i pyetjeve i dedikohen mstjes së distancës etnike. Të anketuarit janë përgjigjur se a janë dhe sa janë të gatshëm që në rrethin e tyre të ngushtë dhe të gjerë të kenë përfaqësues të bashkësive tjera etnike. Matjet janë kryer brenda tri bashkësive më të mëdha etnike që jetojnë në komunën e Bujanocit dhe Preshevës – bashkësinë rome, shqiptare dhe serbe. Bashkësia etnike rome është bashkësia e vetme për të cilën 51% e të anketuarve janë deklaruar se nuk do të dëshironin t'i kenë fqinjë. Më shumë se gjysma e të anketuarve nuk do të dëshironin që romët të jenë edukator të fëmijëve të tyre (66%), që të shoqërohen dhe të vizitojnë romët e kanë kundërshtuar (52%) e të anketuarve, që për shëf të kenë një rom e kanë kundërshtuar (59%) e të anketuarve dhe të jenë në bashkëjetesë martesore me një rom/e ata ose fëmijët e tyre e kanë kundërshtuar 83% e të anketuarve.

Në të gjitha këto aspekte, shqiptarët shprehin shkallë më të lartë të kundërshtimit të bashkëjetesës me romët. Për shembull, të gjithë të anketuarit shqiptar e kanë kundërshtuar martesën e tyre ose të fëmijëve të tyre me romët. Të anketuarit nuk e kundërshtojnë që një përfaqësues rom ta kenë bashkëpunëtor në punë – 62% e të anketuarve kanë përmendur si përgjigje. Kur është në pyetje mardhënie karshi përfaqësuesve të komunitetit shqiptar, më së shumti kundërshtime vërehen në sferën e martesave, 21% e të anketuarve e kundërshton martesën e vet ose të fëmijëve të vet me shqiptar. Kur llogariten të dhënat demografike,

shihet se shkalla më e lartë e kundërshtimit të martesave me shqiptar vjen nga përfaqësuesit e etnisë serbe – 63% e të anketuarve e kundërshtojnë një gjë të till. Në të gjitha pyetjet tjera, pjesa e atyre që kundërshtojnë bashkëjetesën në pjesë të caktuara me shqiptarët është nën 20%. Ngjajshëm sikur me çështjen e martesave, vërehet kundërshtimi i serbëve. Sa i përket atyre, vetëm te kundërshtimi i martesave të përziera të tyre ose të fëmijëve të tyre paraqiten 67% e të anketuarve. Te pyetjet e tjera, mbi gjysma e të anketuarve kanë shprehur mungesë të kundërshtimit – që të kenë fqinjët serb (63%), që të kenë një serb për bashkëpunëtor në punë (82%), të kenë serb/e për edukatorë (56%), që të shoqërohen me një serb dhe të vizitojnë njëri tjetrin (60%), që ta kenë për shëf në punë një përfaqësues të komunitetit serb (71%). Kur janë në pyetje serbët, shqiptarët kanë shprehur shkallë të theksuar të distancës, dhe mbi mesatare kanë zgjedhur të kundërshtojnë bashkëjetesën me serbët përveç që te kenë serb si bashkëpunëtor në punë. Për shembull, pothuajse të gjithë shqiptarët kanë qenë kundër bashkëjetesës martesore me serbët – 97% nga të anketuarit. Duke krahasuar të dhënat demografike, vërehet se gratë/femrat dhe banorët e qyteteve më pak e kundërshtojnë faktin që përfaqësuesit e etnive tjera ti kenë në rrethin e tyre të afërt ose të largët.

Tabela 5.1 A do të kishit kundërshtuar që ndonjërin nga këta ta keni ..., në %

	...të jetë		... të jetë bash		... të jetë edukator-e i fëmijës tuaj		... të shoqëroheni e të vizitoni njëri tjetrin		...të jetë shëfi i juaj		... të jeni në bashkëjetesë martesore Ju ose fëmijët tuaj	
	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo
Romi	51	49	38	62	66	34	52	48	59	41	83	17
Shqiptarë	16	84	16	84	18	82	13	87	16	84	21	79
Serb	37	63	18	82	44	56	40	60	29	71	67	33

Anketuesit janë pyetur se çfarë duhet bërë në rajonin ku jetojnë në mënyrë që të avancohen marrëdhëniet ndëretnike. Zgjidhjet ekonomike nxjerrin pjesën më të madhe të përgjigjeve të tyre – çdo i katërti i anketuar thekson se duhet të ofrohet përkrahje dhe të subvencionohen organizatat biznesore ndërnacionale e cila do të avancoje bashkëpunimin biznesor, përderisa çdo i pesti mendon që është e nevojshme të inicohet bashkëpunimi ekonomik në mes të kompanive nga jugu i Serbisë dhe kompanive rajonale – gjithsejt 45% e të anketuarve. Zgjidhjet ekonomike janë më të popullarizuara në mesin e të anketuarve në komunën e Bujanocit, ku 60% e të anketuarve e kanë përmendur si zgjidhje, ndërsa në komunën e Preshevës një përgjigje të tillë e kanë dhënë 17% e të anketuarve. Organizimi i evenimenteve shkencore, sportive dhe kulturore të cilët do të ofronin popujt në këtë rajon do të ishin aktivitete të qëlluara konsideron 15% e pjestarëve të anketuar. Për ndryshimet në sferën e arsimit janë deklaruar 24% e të anketuarve, prej të cilëve 13% konsiderojnë se duhet të aplikohen shkolla të përbashkëta për të gjithë etnitë të cilat jetojnë në këto komuna, ndërsa 11% e të anketuarve konsideron se duhet të futet mësimi i gjuhës të të gjitha etnive në shkollat ku ato vijojnë mësimet, në mënyrë që të avancohet komunikimi i ndërsjellë. Mësimin e obligueshëm të gjuhës së komuniteteve të tjera, mbi mesatare, e përkrahin serbët dhe romët (20% rrespektivisht 19% e të anketuarve). Më në fund, çdo i njëzetë i anketuar konsideron se duhet të flitet për të kaluarën dhe për pasojat nëpër të cilat ka kaluar ky rajon.

Grafikoni 5.5 Sipas mendimit tuaj, çka është e domosdoshme të bëhet në rajonin ku jetoni në mënyrë që të avancohen marrëdhëniet ndëretnike, në %




6 / Besimi në institucione

Në këtë kapitull është analizuar shkalla e besimit të cilën të qytetarët e rinjë të Preshevës dhe Bujanoc kanë ndaj institucioneve të caktuara, si dhe a mendojnë që institucionet po punojnë mjaftueshëm për pajtimin ndërnacional në këtë shtet.

Dy të tretat e të anketuarve kanë deklaruar se institucionet e Republikës së Serbisë nuk punojnë aspak dhe më shumë nuk punojnë se sa punojnë në pajtimin ndëretnik në këtë shtet. Ata të cilët konsiderojnë që më shumë punojnë se sa nuk punojnë në pajtimin në mes të popujve janë 13% të të anketuarve, ndërsa çdo i njëmbëdhjeti i anketuar (9%) konsideron që institucionet e shtetit të Serbisë punojnë shumë në pajtimin mes popujve në këtë shtet. Që nuk mundën ta vlersojnë se cili do të ishte rroli i institucioneve në këtë drejtim, janë deklaruar 12% e të anketuarve.


Grafikoni 6.1 A mendoni se institucionet e shtetit të Serbisë po punojnë mjaftueshëm në pajtimin ndëretnik në këtë shtet? në %



Pjestarët e komunitetit shqiptar, më shumë se gjysma, kanë deklaruar se institucionet e shtetit të Serbisë nuk punojnë ose më shumë nuk punojnë se sa që punojnë në pajtimin ndëretnik në këtë shtet. Serbët në anën tjetër, më shumë se gjysma, janë deklaruar se shteti më shumë punon se sa që nuk punon ose edhe punon shumë në pajtimin ndëretnik. Të anketuarit më së paku besim kanë ndaj institucionit të presidentit të Republikës së Serbisë dhe Qeverisë së Republikës

së Serbisë. Më së shumti besim kanë ndaj bashkësive fetare dhe pushteteve lokale. Të dhënat në grafikonin më poshtë tregojnë se më shumë se gjysma e të rinjëve (56%) në Preshevë dhe Bujanoc besojnë dhe plotësisht i besojnë institucioneve fetare. Për nga shkalla e besimit janë theksuar edhe pushtetet lokale, për të cilat 38% e të rinjëve janë deklaruar se i besojnë ose i plotësisht i besojnë atyre. Për nga shkalla e mosbesimit më e theksuar është mungesa e besimit ndaj presidentit të Republikës së Serbisë, 66% e të anketuarve ndërsa 62% e tyre kanë deklaruar se nuk i besojnë Qeverisë së Serbisë. Më shumë nuk i besojnë se sa i besojnë edhe Kuvendit popullor, organeve të drejtësisë dhe Trupit Koordinues për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Institucionet që janë theksuar nëpërmjet sentimentit neutral tek të anketuarit (përgjigja „as i besojë e as nuk i besojë“) janë partitë politike dhe pushtetet lokale.

Grafikoni 6.2 Vlerësoni në çfarë mase i besoni institucioneve të radhitura më poshtë në shkallën prej 1 deri 5? në %



Në mesin e atyre ku më shumë se gjysma i besojnë institucioneve fetare janë dalluar kategoritë me shkollim të lartë, nxënësit dhe studentët, shqiptarët dhe të anketuarit nga Presheva. Që aspak nuk kanë besim në Qeverinë e Republikës së Serbisë, janë deklaruar më shumë se gjysma e shqiptarëve dhe romëve, nga Presheva. E në mesin e tyre, më shumë se gjysma që janë deklaruar se nuk i besojnë janë të anketuarit shqiptar që jetojnë nëpër fshatra. Serbët, larg më shumë se gjysma kanë deklaruar se as i besojnë e as nuk i besojnë Qeverisë së Serbisë. Të anketuarit e papunësuar, më shumë se gjysma, kanë deklaruar se nuk kanë besim në institucionin e presidentit të Republikës së Serbisë, e të njejtin qëndrim me ta e ndajnë edhe të anketuarit shqiptar dhe rom. Tek presidenti besim kanë, në më shumë se në gjysmën e rasteve, të punësuarit në administratën publike, sipërmarrësit dhe serbët. Meshkujt, më shumë se gjysma, kanë deklaruar se nuk i besojnë Trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, dhe këtë qëndrim e ndajnë edhe shqiptarët dhe romët. Serbët diku pak më shumë se gjysma kanë treguar besimin e tyre ndaj këtij institucioni. Në pushtetet lokale besim më shumë se mesatarja kanë shqiptarët. Serbët, në më shumë se gjysmën e rasteve, kanë thënë se as kanë e as nuk kanë besim te pushteti lokal në këto dy komuna, përderisa romët, nga më shumë se gjysma e tyre, kanë deklaruar se nuk kanë fare besim në pushtetet lokale.



7 / Perceptimi i konflikteve të armatosura, ballafaqimi me të kaluarën dhe roli i institucioneve të drejtësisë


Sferë e veçant e këtij hulumtimi iu është dedikuar perceptimit të konflikteve të armatosura nga e kaluara tek të rinjtë në Preshevë dhe Bujanoc. Përveç kësaj i kemi pyetur se çka mendojnë për rolin e institucioneve të drejtësisë në procesimin e krimeve të luftës.

Gati se çdo i katërti i anketuar (24%) ka deklaruar se nuk mund të vlersoj se cila nga institucionet e përmendura, me veprimtarinë e sajë, do të i kontribuonte pajtimit mes popujve. Institucioni që më së shpeshti e kanë cilësuar si institucion që do të mundej të i kontribuojë pajtimit është Qeveria e Republikës së Serbisë, të cilën e kanë përzgjedhur 16% e të anketuarve. Në vendin e dytë gjindet pushtetet lokale me 12%. Që asnjë institucion nuk mund të i kontribuoj pajtimit mes popujve janë deklaruar 14% e të anketuarve. Më shumë detaje ndodhen në grafikonin më poshtë.

Në mesin e atyre që mbi gjysma e tyre janë deklaruar se pajtimit do të mund të i kontribuonte Qeveria e Republikës së Serbisë, dallohen të anketuarat femra, të anketuarit nga Presheva dhe shumë përtej mesatares dallohen të anketuarit zanatlinjë.


Të rinjtë e Preshevës dhe Bujanocit janë pyetur se çka mendojnë për konfliktet e armatosura në atë pjesë të vendit dhe çka mendojnë për rolin e popujve të tyre në at konflikt.

Grafikoni 7.1 Sipas mendimit tuaj, cila nga institucionet e poshtëpërmendura, me veprimin e sajë, do të i kontribuonte më së shumti pajtimit në mes popujve? në %



Shumica e të anketuarve (36%) kanë deklaruar se populli të cilit i përkasin është viktimë, ndërsa 35% e tyre kanë deklaruar se populli të cilit ata i përkasin nuk ka bërë asgjë të keqe. Gati çdo i 9 i anketuar (11%) deklaroi se vetëm disa pjesëtarë të komunitetit të tyre kanë bërë keq, ndërsa çdo i dhjeti (10%) konsideron se populli të cilit i takon është poashtu fajtorë si popujt e tjerë që jetojnë në këtë rajon.


Grafikoni 7.2 Kur mendoni për luftën e fundit në Kosovë, konfliktin e armatosur në Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë, çka do ti thonit popullit të cilit i përkisni? në %



Shqiptarët dhe të anketuarit me nivel të mesëm të arsimit, më shumë se në gjysmën e rastave, kanë deklaruar se populli i tyre është viktimë, dhe nuk ka bërë asgjë të keqe. Serbët, mbi mesataren, kanë dhënë përgjigje se populli i tyre është fajtor po aq sa popujt e tjerë që jetojnë në këtë rajon.

Perceptimi i të rinjëve karshi rrolit të popullit të cilit i takojnë në kryerjen e krimeve të luftës ka qenë poashtu pyetje e veçant. Kështu, dy të tretat e të anketuarve (66%) kanë deklaruar se populli të cilit i takojnë nuk ka bërë asgjë të keqe. Cdo i dhjeti i anketuar ka thënë që gjithçka që ka ndodhur ka ndodhur në vetëmbrojtje. Nga 9% e të anketuarve kanë deklaruar se edhe nëse është bërë diçka e keqe është bërë përshkak rrethanave të asaj kohe dhe se të bëmat e popullit të tyre janë më të vogla se të bëmat e popujve tjerë.


Grafikoni 7.3 Në publik ekzistojnë qëndrime se pjestarët e komunitetit që ju i takoni kanë kryer krime lufte. Cili është mendimi Juaj për këtë? në %



Në mesin e të anketuarve të cilët kanë deklaruar se populli i tyre nuk ka bërë asgjë të keqe, mbi mesatarën janë të theksuar të anketuarit që jetojnë në fshatra, të anketuarit shqiptarë, ata që jetojnë në Preshevë. Që gjithçka që është bërë është bërë me qëllim të vetëmbrojtjes kanë deklaruar, në më shumë se në gjysmën e rasteve, të anketuarit që jetojnë në qytete, serbët dhe romët.

Gjithsejt, 61 % e të rinjëve nga Presheva dhe Bujanoci konsiderojnë që është shumë e rëndësishme ose që më shumë është e rëndësishme se sa e parëndësishme të zgjidhen krimet nga e kaluara me qëllim të ndërtimit të një të ardhme më të mirë. Që zgjidhja e krimeve nga e kaluara është më pak e rëndësishme janë deklaruar 13% e të anketuarve, ndërsa 5% e tyre konsideron se zgjidhja e krimeve nga e kaluara është krejtësisht e parëndësishme. Një e pesta e të rinjëve, rreth 21% nuk ka ditur të vlerësojë se në çfarë mase është e rëndësishme zgjidhja e krimeve nga e kaluara me qëllim të ndërtimit të një të ardhme më të mirë.


Grafikoni 7.4 Në çfar mase konsideroni që është e rëndësishme zgjidhja e krimeve nga e kaluara me qëllim të ndërtimit të një të ardhme më të mirë? në %



Të anketuarit nga fshatrat dhe shqiptarët, më shumë se mesatarja, vlerësojnë që është shumë me rëndësi të zgjidhen krimet nga e kaluara për hirë të ndërtimit të një të ardhme më të mirë. Serbët, më shumë se gjysma e tyre, janë përgjigjur se zgjidhja e krimeve është më shumë e rëndësishme se sa që është e parëndësishme.

Më shumë se gjysma e të rinjëve nga Bujanoci dhe Presheva nuk besojnë në efikasitetin e organeve të drejtësisë në Serbi në raport me procesimin e krimeve të luftës. Prej tyre, 27% e të rinjëve të anketuar konsideron se institucionet e drejtësisë nuk janë aspak efikase, ndërsa 30% e tyre vlerëson se më shumë nuk janë se sa që janë efikase. Në total, diçka më shumë se një e pesta (22%) konsideron që këto institucione janë efikase dhe pjesa tjetër që beson se këto institucione janë shumë efikase në procesimin e krimeve të luftës. Pothuajse çdo i pesti i anketuar (21%) konsideron që nuk e din efikasitetin e institucioneve të drejtësisë.


Grafikoni 7.5 A besoni se organet e drejtësisë në Serbi janë efikase në procesimin e krimeve të luftës ? në %



Që nuk janë efikase, më së shumti kanë deklaruar shqiptarët dhe romët, ndërsa shqiptarët në më shumë se në gjysmën e rasteve kanë deklaruar se institucionet e drejtësisë më shumë nuk janë se sa që janë efikase në procesimin e krimeve të luftës. Serbët, më shumë se mesatarisht, kanë deklaruar se besojnë në efikasitetin e ktyre institucioneve.

Qëndrimet e të rinjëve karshi efikasitetit të institucioneve ndërkombëtare të drejtësisë në procesimin e krimeve të luftës janë të ndara. Në fakt, është pothuajse përqindja e njëjtë e atyre që besojnë me ata që nuk besojnë në efikasitetin e tyre. Prej tyre, nëse i shohim si tërësi, 40% e të rinjëve konsiderojnë se këto institucione nuk janë aspak, ose më shumë nuk janë se sa që janë efikase në procesimin e krimeve të luftës. Gjithsejt, 41% e të anketuarve konsideron se institucionet ndërkombëtare të drejtësisë janë shumë efikase ose më shumë janë se sa që nuk janë efikase në procesimin e krimeve të luftës.

Grafikoni 7.6 A besoni se institucionet ndërkombëtare të drejtësisë (sikur gjykata e Hagës) janë efikase në procesimin e krimeve të luftës? në %




Që institucionet ndërkombëtare të drejtësisë nuk janë efikase në procesimin e krimeve të luftës kanë deklaruar, mbi mesataren, shqiptarët, të anketuarit meshkuj, të anketuarit me shkollim të mesëm nga Bujanoci. Gratë/femrat, të anketuarit me shkollim të lartë, nxënësit/studentët, të anketuarit e komunitetit serb kanë deklaruar se besojnë që institucionet ndërkombëtare të drejtësisë janë efikase në procesimin e krimeve të luftës.

Mardhënia e të rinjëve në raport me demokracinë nuk është e njëtrajtshme, prandaj edhe numër i rëndësishëm i të anketuarve ka treguar qëndrim ambivalent ose të luhatshëm karshi demokracisë.

Për rreth një të tretës të të anketuarve (31%) demokracia është forma më e mirë nga të gjitha format e qeverisjes, ndërsa 30% e të anketuarve tjerë konsideron se demokracia është kryesisht forma më e mirë e qeverisjes por jo gjithmonë. Diku rreth një e pesta e të rinjëve (19%) ka deklaruar se për të janë të njëjta regjimet demokratike dhe ato jo demokratike, ndërsa pothuajse çdo i njëmbëdhjeti i anketuar (9%) ka deklaruar se në disa raste qeverisja jodemokratike mund të jetë më e mirë se qeverisja demokratike. Ata të cilët nuk janë deklaruar për këtë çështje përbëjnë 11% e të anketuarve.

Grafikoni 7.7 Kur është fjala te demokracia, cilat nga mendimet e mëposhtme janë më të pranuarat për ju? në %



Që demokracia është forma më e mirë nga të gjitha format tjera të qeverisjes janë deklaruar të anketuarit me shkollim të lartë, nxënësit/studentët, femrat/gratë dhe të anketuarit nga Presheva. Të rinjtë nga shkollat e zanatlinjëve, në më shumë se gjysmën e rasteve, janë deklaruar se qeverisja jodemokratike është më e mirë se qeverisja demokratike.